



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punimjen / Prodatur Received / Delivery	13.04.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHACK	2079/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.206/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.206/2022 të datës 04.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër heshtjes administrative të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.206/2022 e datës 04.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Podujevës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, ankuesit t'i bëjë kompensimin e ndihmës për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-motrës, në shumën monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Podujevës në pozitën "Zyrtar për shpenzime", në kuadër të Drejtorisë për buxhet dhe Financa, me datë 06.01.2022 ka parashtruar kërkesë për kompensim material me rastin vdekjes së anëtarit të familjes tek Njësia e Personelit e Komunës së Podujevës.

Për shkak të heshtjes administrative, ankuesi me datë 01.03.2022 nëpërmjet poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar me datë 04.03.2022 dhe protokolluar me numër:1165/2022, me pretendimet ankimore për kompensimin material me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 08.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Podujevës. Ndërsa, Komuna e Podujevës me datë 15.03.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës. Po ashtu Këshilli me datë 07.04.2022 ka kërkuar prova shtesë nga ankuesi, ndërsa ankuesi me datë 08.04.2022 nëpërmjet e-maili i ka dërguar provat e kërkuara në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.03.2022 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 1165/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e datës 06.01.2022 për parashtrimin e kërkesës apo ankesës; Kërkesa për kompensimin material e datës 06.01.2021; Vërtetimin për vdekje i datës 06.01.2022; Vërtetimin e datës 25.12.2021; Çertifikatën e vdekjes të datës 06.01.2022 me numër serik: V10470116; Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civil i datës 06.01.2022 me numër serik: E25820835; Kopjen e letërnjoftimit të D.S; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Vendimin e kryetarit të Komunës së Podujevës të datës 10.08.2021; Vendimin e kryetarit të Komunës së Podujevës të datës 04.10.2021; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.04.2014; Zarin postar i datës 01.03.2022 me shifër identifikuese R2168205; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.03.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 17.03.2022 me numër protokolli:1430; Ekstraktin nga regjistri i gjendjes civil i datës 14.03.202 me numër serik: E25975456; Zarin postar i datës 15.03.2022 me shifër identifikuese R21682741; E-mailin e datës 07.04.2022 dërguar për ankuesi nga Këshilli; E-mailin e datës 08.04.2022 dërguar ankuesi për Këshillin; Deklaratën e bashkësisë familjare të datës 16.05.2019 me shifër: F10756851; Çertifikatën e lindjes të datës 07.04.2022 me shifër: L24556559.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje duke u bazuar kompetencat e tij dhe pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Në bazë të shkresave të lëndës, Kolegji konstatuar se ankuesi ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.03.2022, kundër heshtjes administrative nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 06.01.2022 e ka parashtruar në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: "Ankesa



*kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.4 ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: Ndhurma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil”* si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafi 2 ku parashihet se: *“Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil”* dhe ka konstatuar që me rastin e vdekjes se anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të kompensimit në shumën monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Lidhur me sqarimet e përkufizimit se kush përcaktohet si anëtar i ngushtë i familjes, Kolegji iu është referuar Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: *“Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji”*. Lidhur me këtë, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes se anëtarit të familjes.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Deklaratën e bashkësisë familjare me shifër: F10756851 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Podujevë me datë 16.05.2019, Çertifikatën e lindjes së ankuesit me shifër: L24556559 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Podujevë me datë 07.04.2022, Çertifikatën e vdekjes me numër serik: V10470116 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Podujevë me datë 06.01.2022 si dhe Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civil me numër serik: E25820835 i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Podujevë me datë 06.01.2022, Kolegji ka gjetur se ankuesi më të ndjerën janë në lidhje gjaku, motër e vëlla, nga të njëjtit prindër dhe të njëjtit kanë jetuar dhe i kanë ndarë të mirat materiale së bashku, prandaj këto të dhëna zyrtare janë fakte të provueshme të cilat përmbushin parakushtet e përcaktuara ligjore të përcaktuara me nenin 271 të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me kompensimin për rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes janë të bazuara, të qëndrueshme dhe të mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi, andaj Komuna e Podujevës në kuptim të zbatimit të dispozitave ligjore të pasqyruara si më lart është e obliguar që ankuesit t'i bëjë kompensimin e ndihmës-pagesës për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-motrës, në shumën monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 4 të Ligjit

Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.206/2022**

**Flakron GASHI**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

